



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Prizetuar Primi / Prilato Received / Delivered	22-06	2021	1	veti total total
Organ / Dësia Organ / Dësia Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtypje Puleg Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMB/2021	3260/2021		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A. nr. 526/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar kërkesën për pezullim të ekzekutimit të Vendimit Bordit të KRPP-së nr.31/2021 i datës 31.05.2021 të bashkangjitur në ankesën A.nr. 526/2021, të datës 10.06.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimin: Fshati Sllatinë e Epërme, Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson me autorizim Avokati me adresë Rruga “Fehmi Agani” Hyrja nr.154, Kati I, nr.8 Komuna e Prishtinës, kundër Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënie e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 130 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Apropohet** kërkesa për pezullim e datës 10.06.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Pezullohet** ekzekutimi i Vendimit të Bordit të KRPP-së nr.31/2021 i datës 31.05.2021 deri në shqyrtimin kryesor dhe vendosjen e ankesës së datës 10.06.2021.
- III. Obligohet** Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik që të bëjë zbatimin e këtij vendimin në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 10.06.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me numër protokoli:31/2021 të datës 31.05.2021.



Përfaqësuesi i autorizuar i palës së bashkë më ankesën e ankuesit të datës 10.06.2021 ka parashtruar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Bordit të KRPP-së me Nr.31/2021 të datës 31.05.2021 duke bashkangjitur edhe kërkesën e datës 07.06.2021 të Kryetarit të Komunës së Vitisë i cili kërkon pezullimin e ekzekutimit të të njëjtit vendim.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për pezullim, janë administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 10.06.2021 me numër protkoll:3005/21 së bashku me kërkesën për pezullim të Vendimit të Bordit të KRPP-së nr.31/2021 i datës 31.05.2021; Autorizimin e palës përfaqësuese të datës 04.06.2021; Kërkesën për pezullim të Kryetarit të Komunës së Vitisë të datës 07.06.2021; Vendimit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me numër protokoll:31/2021 i datës 31.05.2021; Raporti final i datës 01.04.2021 i përpiluar nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesës së OSHP-së të datës 13.01.2021; Njoftimin e OSHP-së e datës 30.12.2020; Vendimin e Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të datës 13.01.2021 me numër 01/2021; Akt emërimit e ankuesit të datës 12.03.2013 me numër 02-112/199; Çertifikatën e avancuar profesionale për prokurim me numër:339 e vitit 2020 lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik për ankuesin

Në bazë të akt emërimit të ankuesit të datës 12.03.2013 me numër 02-112/199 është konstatuar se i njëjti ushtron pozitën e “Udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit” në kuadër të Komunës së Vitisë.

Po ashtu, gjatë analizimit të kërkesës për pezullim të ekzekutimit të vendimit është konstatuar se me Vendim të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me numër protokoll:31/2021 të datës 31.05.2021 ankuesit është anuluar Çertifikata e avancuar profesionale për prokurim me numër:339 e vitit 2020 lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, rrjedhimisht ankuesit i pa mundësohet të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësit të përcaktuara në akt emërimit e datës 12.03.2013 me numër 02-112/199, ndërsa në kërkesën e datës 07.06.2021 e Kryetarit të Komunës së Vitisë kërkohet, citoj: ***“Për shkak se në komunën tonë nga të gjithë të punësuarit, me licencë për prokurim është i certifikuar vetëm z. [emri] dhe duke pasur parasysh nevojën për zhvillimin e procedurave dhe lidhjen e kontratave për projektet kapitale që kemi të buxhetuara për vitin 2021, kërkojmë nga organi administrativ që konform dispozitave ligjore të procedurës së përgjithshme administrative të beje pezullimin e vendimit për revokim të Licencës së z. [emri] dukës mos paragjykuar përfundimin e gjyqimit të çështjes nga organi në fjalë”.***

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë të kërkesës për pezullim të ekzekutimit të Vendimit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me numër protokoll:31/2021 i datës 31.05.2021, janë analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 130 paragrafin 3 i cili përcakton se: ***“Organi publik, i cili shqyrton ankesën, mund të vendosë me akt administrativ, ndalimin e efektit pezullues të tij, nëse vonesa në ekzekutimin e tij mund t’i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm interesit publik apo një pale të tretë. Akti për heqjen e efektit pezullues, përveç elementeve të parapara nga neni 47 i këtij Ligji, do të përfshijë arsyetimin e ekzistencës së kushteve të parashikuara nga ky paragraf”***, andaj mbi këtë bazë si duke marra parasysh kërkesën e kryetarit të Komunës së Vitisë të datës 07.06.2021 me qëllim të jetësimit të projekteve kapitale të cilat kanë për qëllim interesin publik, ndërsa pezullimi apo mos realizim i tyre i sjell komunitetit dëme të pariparueshme, kërkesa për pezullim të ekzekutimit të Vendimit numër protokoll:31/2021 i datës 31.05.2021 të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, aprovohet deri ne momentin e shqyrtimit kryesor dhe vendosjes se ankesës së ankuesit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është i obliguar ta pezullojë ekzekutimin e Vendimit me numër protokoll:31/2021 të datës 31.05.2021 si dhe të gjitha efektet dhe vendimet tjera juridike që rrjedhin prej tij, deri ne shqyrtimin kryesor dhe vendosjes se ankesës së ankuesit të datës 10.06.2021 siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 17 paragrafi 1 i cili përcakton se: ***“Këshilli brenda afatit prej dyzetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim duke e arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes.***



Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 130 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.526/2021

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Përfaqësuesit të autorizuar të palës
- Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

